 - a) Nga Konkordija SH.P.K i përfaqësuar nga z. Remzush Beqiri si qiramarrës i pjesës së tokës afariste e identifikuar me nr.198 në sipërfaqe prej 80m2, e cila ndodhet në Tregun me Shumicë tek Joni-Mix SH.P.K në shumën prej 240.00 Euro/muaj;
 - b) Nga Luan Xheladini si qiramarrës i pjesës së tokës afariste nr.18 me sipërfaqe prej 14m2 dhe D.P.T "Hekraria te Luani" përfaqësuar nga Luan Xheladini si qiramarrës i pjesëve të tokave afariste 22 dhe 23 të në Tregun te ish-Amortizatorët tek Hekraria Luani SH.P.K në shumën prej 200.00 Euro/muaj;
- II. Para lidhjes së aneks kontratave të qirasë të transferuara tek personat e lartcekur, Qiramarrësit aktual do të jenë të obliguar të paguajnë borxhin e papaguar, ose në të kundërtën do të ndermirren të gjitha veprimet ligjore për inkasimin e borxhit të papaguar dhe lirim të hapësirave:
 - a) Qiramarrësi Konkordija SH.P. K si qiramarrës i pjesës së tokës afariste 198 me sipërfaqe prej 80m2 tek Tregun te ish-Amortizatorët para bartjes së kontratës së qirasë tek Joni-Mix SH.P. K është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 3,371.56€ Euro;
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se NSH "Tregu" Prishtinë PRN104, është në proces të likuidimit që nga data 14 Korrik 2014. Kjo ndërmarrje ka vazhduar me aktivitetet e saj edhe gjatë procesit të likuidimit kryesisht në qiradhënie të hapësirave afariste.

Më datë 10.05.2024, ZR Prishtinë ka pranuar kërkesën me nr. protokollit 24751/2024 e parashtruar nga pala z. Remzush Beqiri përfaqësues i kompanisë Konkordija SH.P.K, për transferimin e kontratës të qirasë në emër të kompanisë Joni Mix SH.P.K e regjistruar në MTI-ARBK me NUI:812010461. Qiramarrësi Konkordija SH.P.K ka hyrë në kontratë të qirasë me datë 17.09.2015 me nr. protokollit 7682/2015 për shfrytëzimin e tokës afariste e identifikuar me nr.198 me sipërfaqe 80m2 e ndodhur tek Tregu me Shumicë në Zonën Industriale në Prishtinë (ish Fabrika e Amortizatorëve), në shumën prej 240.00 Euro/muaj. I njëjti ka kontratë aktive të qirasë dhe shuma e borxhit të papaguar është 3,371.56€ me muajin korrik 2024. Në kërkesën e parashtruar nga kompania Konkordija SH.P.K thuhet që të gjitha obligimet ndaj AKP-së/AL-së do të merr përsipër kompania Joni-Mix SH.P.K

Më datë 11.06.2024, ZR Prishtinë ka pranuar shkresën me nr. protokollit 24715/2024 të parashtruar nga z. Luan Xheladini përfaqësues i kompanisë D.P.T "Hekraria te Luani". Parashtruesi në fjalë me anë të kësaj



shkresë ka kërkuar transferimin e kontratave të qirasë për hapësirat afariste nr. 18 dhe 22, 23 tek Hekraria Luani SH.P.K me NUI: 811885500. Qiramarrësi Luan Xheladini është shfrytëzues i tokës afariste nr.18 me sipërfaqe prej 14m2 në bazë të kontratës së qirasë me nr.prot 475 e datës 27.01.2015 në shumën prej 50€/muaj dhe i hapësirave afariste 22 dhe 23 të cilat i shfrytëzon në bazë të kontratës me nr.prot.984 e datës 03.02.2015 në shumën prej 150.00 Euro/muaj, të ndodhura në Anex Tregun me Shumicë në Zonën Industriale në Prishtinë (ish Fabrika e Amortizatorëve). I njëjti nuk ka kontratë aktive të qirasë, pasi që ka kërkuar që të bëhet transferimi i kontratave të qirasë. Mirëpo edhe pse nuk ka kontratë aktive, të njëjtit i janë lëshuar faturat dhe nuk ka borxhe të papaguara.

Conkordija SH.P.K përfaqësuar nga z. Remzush Beqiri për tokën afariste nr.198 tek Tregu me Shumicë, në sipërfaqe prej 80m2 ka borxh të papaguar në shumën prej 3,371.56 Euro. Para nënshkrimit të kontratës të transferuar tek Joni-Mix SH.P.K në rast të aprovimit të kërkesës nga ana e Bordit të Drejtorëve do të kërkohej që të paguajë këtë borxh të papaguar, në të kundërtën kontrata e transferuar nuk do të nënshkruhet dhe do të kërkohej që parashtruesi i kërkesës të lirojë hapësirën dhe për borxhin e papaguar do të ndërmirren veprime ligjore.

Qiramarrësi Luan Xheladini si përfaqësues i kompanisë D.P.T “Hekraria te Luani” dhe tek kontrata tjetër si person fizik nuk ka borxhe të papaguara.

Kontratat tek personat tek të cilët do të transferohen nuk do të dorëzohen deri sa të paguajnë borxhin e papaguar, dhe po ashtu do të ndërmirren të gjitha veprimet ligjore në rast se ky borxh nuk paguhet dhe do të kërkohej edhe lirimi i pjesëve të tokave afariste specifika.

Në këtë rast duhet të kemi parasysh, siç është diskutuar deri më tani se NSh Tregu është me karakter specifik dhe hapësirat e vendosura në tokën afariste janë të ndërtuara nga vetë qiramarrësit dhe me këtë vendim lejohet transferimi i kontratave të qirasë edhe pse në mes të qiramarrësit dhe personit që pranon transferimin e kontratës së qirasë nuk ka lidhje familjare dhe Agjencia ka parasysh se cedimi apo transferimi i këtyre kontratave të qirasë ju bëhet personave që ushtrojnë veprimtari të tregtisë.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-206/98

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërliohen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Nenit 10.1.5 të Rregullores Nr. Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për ndryshim të kontratës së qirasë me nr. protokollit OUT/45378/2022 të datës 11.03.2022, e vazhduar me aneks kontratën me nr. protokollit OUT/48775/2024 të datës 04/04/2024 në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSH "Farmakos" dhe Bas Vek International Sh.P.K., ashtu që të vazhdohet kontrata për ngastrën kadastrale P-71813068-9010-4 ZK Prizren me sipërfaqe prej 47776 m² me qiramarrësin Bas Vek International Sh.P.K. me çmimin prej 1,998.10 €/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhimentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

Ngastra kadastrale P-71813068-9010-1 e njohur si Fabrika e Kaltër – Farmakos Prizren, prej të cilave 1867 m² me kulturë ndërtesë, ndërsa pjesa prej 57993 m² me kulturë tokë "jopjellore" kanë qenë të lëshuara me qira në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-159/10 për qiramarrësin Bas Vek International Sh.P.K. përmes tenderit publik për qiradhënie. Kjo ngastër ka qenë pa ndarje dhe e gjitha ka qenë në pronësi të NSH "Farmakos" Prizren. Në bazë të Aktgjykimit të plotfuqishëm të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme AC-I-23-0143 i është njohur pronësia pasardhëse të Hamdi Ajazaj në ngastrën nr. 9006 në sipërfaqe prej 01.20.32 ha ZK Prizren. Ngastra kadastrale nr. 9006 i është bashkuar ngastrës kadastrale nr. 9010 dhe kështu ka qenë në shfrytëzim dhe pronësi të NSH "Farmakos". Kjo në bazë të regjistrimit të ndërrimeve nr. 175/92. Në bazë të këtij aktgjykimi, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër – Prizren më datë 19.06.2024 ka nxjerrë aktvendim me të cilin ka aprovuar kërkesën e Imri Ajazaj dhe ka bërë regjistrimin e parcelës P-71813068-09010-3 në bazë të aktgjykimit të DhPGJSK-së AC-I-23-0143 në pjesë ideale të secilës prej palëve të përfshira në procedurë, në sipërfaqen totale prej 12024 m². Si rrjedhojë e kësaj, është krijuar parcela P-71813068-09010-4 me sipërfaqe prej 4777 m², e cila vazhdon të mbetet në pronësi të NSH Farmakos. Kontrata e qirasë me Bas Vek International Sh.P.K. Prizren është vazhduar me aneks kontratë më datë 04.04.2024 dhe për shkak të ndryshimeve në bazë të aktgjykimit të lartcekur, kërkohet që të bëhet ndryshimi i kontratës së qirasë.


Ky aset është dhënë me qira përmes tenderit publik dhe pas ofertimit qiramarrësi është shpallur fitues në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-159/10 të datës 28/02/2022. Sipas vlerësimit të AL-së, vazhdimi i kontratës së qirasë në bazë të sipërfaqes faktike që aktualisht shfrytëzohet nga qiramarrësi do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2024




Meftor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-206-99

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 korrik 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për NSh "Ereniku Industria" PEJ007 (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej € 20,000.00 dhe atë për vijët buxhetore si në vijim:
e22 (Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve) në vlerën prej € 20,000.00
- II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSh "Ereniku Industria" PEJ007.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit për NSh "Ereniku Industria" PEJ007. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-206/100

Në bazë të neneve 9 dhe 15.2.13 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 5 dhe 16 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të ndryshuar me nenin 20 të Ligjit 06/L-023 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Të iniciohen procedurat e likuidimit për Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet të paraqitura në tabelën e mëposhtme, duke përfshirë edhe miratimin e buxhetit 2 vjeçar të likuidimit të vlerësuar për Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet një nga një, ndërsa shpenzimet e buxhetit realizohen në bazë të nenit 16 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndryshuar me nenin 20 të Ligjit nr. 06/L-023 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Nr.	ID e NSh-së	Emri i NSh-së	Kategoria	Komuna	Regjioni
1	PRN197	Uniprom	Aset	Prishtinë	Prishtinë
2	PRN201	Zhitomlin	Aset	Svetozarevë	Prishtinë

- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të emëroj Autoritetet e Likuidimit (AL) për secilën Ndërmarrje Shoqërore/Aset nga pika (i) e Vendimit të Bordit (përfshirë çfarëdo zëvendësimi të kohëpaskohshëm);
- III. Miratohet shitja e të gjitha asetëve "Sipas ligjit dhe akteve nënligjore të AKP-së", të cilat janë të listuara në dokumentet "Përmbledhje për Bord" (Board Brief) për ndërmarrjet/asetet e propozuara për fillim të procedurave të likuidimit;
- IV. Vendimi për likuidim dhe fillimi i procedurave të likuidimit hyn në fuqi me datë 9 gusht 2024.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe aprovoi sipas procedurave inicimin e procedurave të likuidimit për tre ndërmarrjet/asetet me arsyetimet sikurse në vijim:

- i. PRN197 "Uniprom" - Prishtinë - Bazuar në analizën ligjore të dokumentacionit përkatës, statusi i këtij asetit ka qenë i shqyrtuar nga Zyra Rajonale e AKP-së. Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Asetit dhe sipas rekomandimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 23 maj 2024 ka aprovuar raportin përfundimtar dhe rekomandimin e Komisionit dhe qëndrimi i tyre është se i njëjti bie nën administrimin e AKP-së (SDR/KPS-1538/PRN197), sipas nenit 5.1 të Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në. Në bazë të dokumenteve që posedon ZR Prishtinë, O.P.B. "UNIPROM" dhe O.T.H.P.B. "Jošanica" Novi Pazar, asetet në Prishtinë/Kosovë si dhe çdo aset tjetër që do të identifikohet në të ardhmen e që i takon ndërmarrjes në fjalë, në territorin e Kosovës, është pronë në pronësi shoqërore dhe bie nën kompetencat e AKP-së konform nenit 5.1 të Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në. Në bazë të dokumenteve kadastrale asetit i përmendur ka ngastrën numër 01503-0, zona kadastrale Prishtinë me sipërfaqe të përgjithshme prej 12,170 m². Ky është i vetmi aset që gjendet në Kosovë që është i lidhur me O.P.B. "UNIPROM" dhe O.T.H.P.B "Jošanica". Toka e përmendur, e cila gjendet në Kosovë në Prishtinë në Zonën Industriale, është shitur në ankand nga shoqëria aksionare Jošanica/Joshanica personit fizik nga Çagllavica z.Sreten Mitroviq më 29.06.2002 për shumën prej 243.000 euro. Ndërkohë, blerësi i lartpërmendur nuk ka pasur para të mjaftueshme për të paguar shumën totale dhe ka paguar vetëm një depozitë në shumën prej 15% të çmimit total dhe më pas ka gjetur një blerës të ri,



z. Adem Hasi, pronari i kompanisë private N.T.P. "Metal" nga Glllogoci, me të cilin lidh marrëveshje trepalëshe për lidhjen e kontratës së shitjes në vlerë prej 250.000 euro si shitës. N.T.P. "Metali" detyrohet t'i paguajë blerësit paradhënien që ia ka paguar shoqërisë aksionare "Jošanica" dhe pjesën tjetër deri në çmimin total të dakorduar. Rasti është zgjidhur në të gjitha gjykatat e Kosovës nga Gjykata Komunale, Gjykata e Qarkut dhe gjithashtu në DhPGjSK. Në bazë të certifikatës së pronësisë, toka e përmendur ende menaxhohet nga O.P.B. "Uniprom".

- ii. PRN209 "Zhitomlin" - Svetozarevë - Bazuar në analizën ligjore të dokumentacionit përkatës, statusi i këtij aseti ka qenë i shqyrtuar nga Zyra Rajonale e AKP-së. Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Asetit dhe sipas rekomandimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 23 maj 2024 ka aprovuar raportin përfundimtar dhe rekomandimin e Komisionit dhe qëndrimi i tyre është se i njëjti bie nën administrimin e AKP-së (SDR/KPS-1540/PRN201), sipas nenit 5.1 të Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në. Në bazë të dokumenteve që posedon ZR Prishtinë, OP "Zhitomlin" OTHPB "Trgovina" nga Svetozareva - Përfaqësia e Prishtinës, asetet në Prishtinë/ Kosovë si dhe çdo aset tjetër që do të identifikohet në të ardhmen e që i takon ndërmarrjes në fjalë, në territorin e Kosovës, është pronë në pronësi shoqërore dhe bie nën kompetencat e AKP-së konform nenit 5.1 të Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në. Në bazë të hulumtimeve të realizuar nga ZR Prishtinë nuk është identifikuar ende asnjë aset i ndërmarrjes në Prishtinë/Kosovë. Nga disa dokumente të siguruar nga ZR Prishtinë lënë të kuptojnë se kjo ndërmarrje ka pas përfaqësinë në Prishtinë dhe lokale në të cilat ka ushtruar veprimtarinë e vet. Disa prej lokaleve janë në pronësi të personave privat por disa të tjera kanë mbetur të pa identifikuar sa i përket pronësisë. Nuk është identifikuar asnjë aset në Prishtinë në pronësi të OPB "Zhitomlin" Kombinati Ushqimor OTHPB "Trgovina" Svetozarevo, Përfaqësia në Prishtinë/ Kosovë, por vetëm asete në pronësi private të cilat janë marrë me qira nga ndërmarrja dhe në të cilat është ushtruar veprimtaria e ndërmarrjes që ishte shitja e produkteve nga gruri dhe artikujve tjerë ushqimorë.

Duke marrë parasysh faktet si më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2024.



Mentor Hyseni

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-206-101

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 korrik 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Apropohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për PEJ093 "Boksitet e Kosovës" (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej € 66,000.00 dhe atë për vijet buxhetore si në vijim:
e22 (Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe asetëve) në vlerën prej € 66,000.00
- II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të PEJ093 "Boksitet e Kosovës"

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe asetëve pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit për PEJ093 "Boksitet e Kosovës" Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:


Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2024.




Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-206/102

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 korrik 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për NSH PRN173 New Co Grand Hotel (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej € 4,771,000.00 dhe atë për vijat buxhetore në vijim:
1. e11 (Paratë e imta të mbyllura Shpenzimet,aktuale për shpenzime të vogla të likuidimi) në vlerën prej 20,000.00 €;
 2. e14 (Shpenzimet e Gjykatës) në vlerën prej 5,000.00€
 3. e17 (Ofruesit e Shërbimeve (Pagesat Bruto), në vlerën prej 150,000.00€
 4. e18 (Ofruesit e shërbimeve (Pagesat Neto)) në vlerën prej 2,200,000.00 €;
 5. e19 (Tatimi i të ardhurave personale për ofruesit e shërbimeve) në vlerën prej 250,000.00 €;
 6. e20 (Shërbimet Profesionale) në vlerën prej 4,000.00€
 7. e22 (Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve) në vlerën prej 330,000.00 €; ,
 8. e27 (Mallrat), në vlerë prej 200,000.00 €,
 9. e29 (Shërbimet) në vlerën prej 650,000.00 €;
 - 10.e30 (Ujë) në vlerën prej 110,000.00 €;
 - 11.e31 (Energji Elektrike) në vlerën prej 800,000.00 €;
 - 12.e32 (Mbeturinat) në vlerën prej 10,000.00 €;
 - 13.e33 (Telekomunikacioni) në vlerën prej 30,000.00 €
 - 14.e36 (Tatimi në pronë(Komunës) në vlerën prej 10,000.00€
 - 15.e38 (Tatimi i korporatës) në vlerën prej 2,000.00€
- II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


ARSYETIM


Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSH PRN173 New Co Grand Hotel.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për paratë e imta të mbyllura Shpenzimet aktuale për shpenzime të vogla të likuidimit, Shpenzimet e Gjykatës, Ofruesit e Shërbimeve (Pagesat Bruto), Ofruesit e shërbimeve (Pagesat Neto), Tatimi i të ardhurave personale për ofruesit e shërbimeve), Shërbimet Profesionale, Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe aseteve Mallrat, Shërbimet, Ujë, Energji Elektrike, Telekomunikacioni, Tatimi në pronë(Komunës), Tatimi i korporatës) - pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit për NSH PRN173 New Co Grand Hotel. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 30 korrik 2024.




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-206/103

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 korrik 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për NSH PRN104 Tregu (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej € 1,552.000.00 dhe atë për vijat buxhetore në vijim:
1. e11 (Paratë e imta të mbyllura Shpenzimet aktuale për shpenzime të vogla të likuidimi) në vlerën prej 20,000.00 €;
 2. e18 (Ofruesit e shërbimeve (Pagesat Neto)) në vlerën prej 250,000.00 €;
 3. e19 (Tatimi i të ardhurave personale për ofruesit e shërbimeve) në vlerën prej 240,000.00 €;
 4. e22 (Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe asetëve) në vlerën prej 575,000.00 €;
 5. e25 (Qiraja e paguar (Bruto)), në vlerë prej 86,000.00 €;
 6. e27 (Mallrat), në vlerë prej 5,000.00 €;
 7. e29 (Shërbimet) në vlerën prej 300,000.00 €;
 8. e30 (Ujë) në vlerën prej 12,000.00 €;
 9. e31 (Energji Elektrike) në vlerën prej 24,000.00 €;
 10. e32 (Mbeturinat) në vlerën prej 20,000.00 €;
 11. e33 (Telekomunikacioni) në vlerën prej 20,000.00 €;
- II. Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSH PRN104 Tregu.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për Paratë e imta të mbyllura Shpenzimet aktuale për shpenzime të vogla të likuidimi, Ofruesit e shërbimeve (Pagesat Neto), Tatimi i të ardhurave personale për ofruesit e shërbimeve, Shërbimet për mbrojtjen e pronës dhe asetëve, Qiraja e paguar (Bruto), Mallrat, Shërbimet, Ujë, Energji Elektrike Mbeturina, Telekomunikacionin - pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit për NSH PRN104 Tregu . Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-206/104

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datat 30 korrik 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Anulohet vendimi Nr. Ref. BD-146/25 i Bordit të Drejtorëve të datës 25.02.2021 për aprovimin e raportit të shpërndarjes së përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh "Çeliku" GJI060, vetëm në raport me kreditorin me numër rendor 360 (të paraqitur në shtojcën nr. 4 të raportit të shpërndarjes të shkurtit 2021), ashtu që shpërndarja për këta kreditor të bëhet konform këtij raporti.
- II. Aprovohet Raporti Korrigjues i Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Çeliku, GJI060 (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Raportin Korrigjues të Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Çeliku, GJI060 (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.

Ky vendim u aprovua bazuar në faktin se Raporti i shpërndarjes së përkohshme për NSh "Çeliku" GJI060 është aprovuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve më datë 25.02.2021 me vendimin Nr. Ref. BD-146/25, mirëpo në raportin e paraqitur kishte ndodhur një lëshim teknik sepse në shumën totale të aprovuar për kreditorin me nr. rendor 360 të paraqitur në shtojcën nr. 4 (që përfshijnë një numër prej 151 kreditorëve që do të paguhen në emër të kontributeve pensionale) ishte paraqitur shuma gabim dhe pasi që janë gjetur listat e punëtorëve në arkivin e NSh-së janë verifikuar dhe janë bërë llogaritjet edhe në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale Gjilan C.nr. 590/05 deri C.nr. 629/05 dhe shuma është specifikuar në shtojcën nr. 3 të këtij raporti të shpërndarjes.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se pasi që të parashtrohet kërkesa tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe pasi që kjo pagesë të kryhet deri në pjesën sa do të mbulojë pagesat e kreditorëve, atëherë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin Korrigjues të Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Çeliku, GJI060 (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-206/105

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Nenit 10.1.2.3 të Rregullores Nr. Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurën e Likuidimit të NSH-ve, Neneve 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie respektivisht kërkesa e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për qiramarrjen e pronës - lokal afarist më sipërfaqe prej 355 m² pronë e NSH Bankkos PRN125, me çmimin total prej 200.00 Euro/muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

Me datë 22.05.2024, AKP, ka pranuar një kërkesë të parashtruar nga Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit përmes së cilës kërkon marrjen me qira të pronës së lartcekur - vetëm katin e I-rë me sipërfaqe prej 355m². Plotësimi i kërkesës është bërë edhe më datë 12 korrik 2024 me shkresën me nr. protokollit 1088.

Pasi që parashtrues i kërkesës është Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës konform nenit 10 par.3 të Rregullores Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aset do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik. Në lidhje me këtë, në plotësimin e kërkesës më datë 12 korrik 2024, MPB ka deklaruar se ka mundësi të paguaj shumëën prej 200.00 Euro në muaj (bruto).

Ky aset nuk është në listën e aseteve të cilat i janë propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me strategjinë për krijimin e Fondit Sovran, por është i kategorizuar si aset për tu privatizuar nga AKP në valët e ardhshme të shitjes.


Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i kontratës së qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2024




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-206/106

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Menaxhmentit të AKP-së për pronën e NSh Metaliku që:
- Që të arrihet marrëveshje me qiramarrësin Rroni Fer me përfaqësues Labinot Kameri, që për hapësirën e hallës të paguaj çmimin prej 0,23€/m2 prej datës kur i është ofruar oborri përballë hallës së ndërtuar për zhvillim në sipërfaqe prej 14939 m2 për qira direkte, nga 01 shkurt 2023, si dhe të paguaj në mënyrë retroaktive qiranë për hapësirën e hallës në vlerë prej 31.960.43 € (bruto), ku kjo zgjidhje do të siguroj të hyra të garantuara nga kjo kontratë qiraje.
 - T'i sigurohet hapësira e nevojshme përcjellëse përreth hallës së prodhimit, ku kjo do të jetë pjesë e kontratës së qirasë të nënshkruar për shfrytëzim të hallës së ndërtuar për zhvillim.
 - Pjesa e cila është e gjelbëruar dhe nuk shfrytëzohet për biznes nuk do të jetë subjekt i qiramarrjes.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për shqyrtimi e çështjes së palës Rroni Fer për pagesë të obligimeve të qirasë për pronën e NSh Metaliku.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin ka qenë pikë veprimi i Bordit në mbledhjen 23.05.2024 që qiramarrësit Rroni Fer ti ofrohet çmimi prej 0,23 €/m2 për hapësirën e hallës si dhe t'i sigurohet hapësira e nevojshme përcjellëse përreth Hallës së prodhimit, prej datës kur i është ofruar prona për qira direkte, si dhe pas refuzimit të palës dhe kërkesës së Bordit që të diskutohet me palën, është propozuar vendimi si në dispozitiv.

Duke marrë për bazë se Qiramarrësi Rroni Fer, ka deklaruar se e ka shfrytëzuar pronën për rreth objektit për tu qasur në objekt nga fillimi i kontratës, pasi që sipas tij ka qenë e nënkuptueshme se marrja me qira e objektit nënkupton edhe sigurimin e qasjes në objekt por e cila nuk ka qenë e përshtatshme, dhe nga kjo kohë ka filluar të investoj brenda objektit dhe ndërkohe ka filluar ta investoj edhe në hapësirën për rreth objektit për qasje në objekt, mirëpo për rregullim të hapësirës për rreth objektit përfundimi i punimeve për shfrytëzim si vendosja e rrethojave, mbjellja e gjelbërimit dhe asfaltimi i qasjeve në objekt janë bere ne një kohe te me vonshme me qellim te funksionalizimit te objektit dhe rritjes së vlerës së asetit. Si dhe duke vlerësuar se Rroni Fer është prodhues, eksportues dhe njeri nga tatim paguesit e mëdhenj në Kosovë, propozon që vlera e caktuar prej 0.23 €/m2 të filloj të rrjedh nga data 01 shkurt 2023.

Duke marrë parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2024



Mentor Hyseni
Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit